

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6486
E premte, 10 dhjetor 2021
çmimi 0.40 €

Specialja ua vazhdon paraburgimin Veselit, Krasniqit dhe Selimit

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) KANË VENDOSUR NË LISTËN
E SANKSIONEVE DHJETËRA SERBË TË VERIUT TË KOSOVËS

FAQE 4-5

SHBA-ja SANKSIONON KRIMINELËT E VERIUT



Zyra e Kontrollit për Pasuritë e Huaja e Departamentit të Thesarit ka goditur grupin e biznesmenit serb Zvonko Veselinović, duke i vënë sanksione. Dhjetëra individë të këtij grupi akuzohen për marrëveshje me politikanët në veri të Kosovës, për ta ndihmuar fitoren e tyre në zgjedhje dhe mbështetjen financiare për ta. Një veprim i tillë i ShBA-së është përshëndetur nga spektri politik i Kosovës. Institucionet e Kosovës kanë paralajmëruar se personat e sanksionuar do të hetohen edhe nga drejtësia vendore

AKTUALE



**MEHMET KRAJA RIZGJEDHET
KRYETAR I AKADEMISË SË
SHKENCAVE DHE ARTEVE TË
KOSOVËS** F. 7

**KURTI: REFORMIMI I PROKURIMIT
PUBLIK, NDËR PIKAT MË TË
RËNDËSISHME NË LUFTIMIN E
KORRUPSIONIT** F. 5

**MINISTRI I SHËNDËTËSISË NUK
TAKOHET ME SPECIALIZANTËT,
KËTA PARALAJMËROJNË
VAZHDIMIN E PROTESTAVE** F. 7

**SYLA, THIRRJE KURTIT:
MOS E VËSHTRËSO JETËN
E ÇLIRIMTARËVE!** F. 6

I jepet lumturia e fundit babait të heroit Enver Zymberi

FAQE 7



**OSMANI NË SAMITIN PËR DEMOKRACI:
KOSOVA LUFTOI REGJIMET
AUTORITARE DHE GJENOCIDALE**

FAQE 3

EKONOMI



**GATI NË PËRFUNDIM PLANI
PËR HEKURUDHËN
PRISHTINË - DURRËS** F. 8

**56 PËR QIND E BIZNESEVE TË
ANKETUARA MENDOJNË SE KOR-
RUPSIONI NË PROKURIM PUBLIK
ËSHTË I PRANISHËM** F. 8

SPORT

**KOK-u NDAU SHPËRBLIMET PËR LO
'TOKYO 2020' DHE NËNSHKROI
BURSAT OLIMPIKE 'PARIS 2024'** F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVIÇË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Numër rekord i gazetarëve të burgosur këtë vit

NJU-JORK, 9 DHJETOR - Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve ka njoftuar se numri i gazetarëve të burgosur në mbarë botën ka shënuar rekord të ri në vitin 2021. Në raportin e publikuar të enjten bëhet me dije se 293 gazetarë janë burgosur gjatë këtij viti për shkak të punës së tyre. Në vitin 2020, gazetarë të burgosur kanë qenë 280. Është ky viti i gjashtë radhazi që Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve regjistron së paku 250 gazetarë të burgosur. Për më tepër, sipas organizatës, 19 gazetarë janë vrarë në shenjë hakmarrjeje për punën e tyre deri më 1

dhjetor të këtij viti. Gjatë gjithë vitit 2020 numri i gazetarëve të vrarë ka qenë 22. Tetëmbëdhjetë të tjerë kanë vdekur në rrethana shumë të errëta dhe është e vështirë të përcaktohet nëse janë vrarë, tha raporti. Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve tha se tre gazetarë u vranë gjatë këtij viti tek raportonin nga zonat e konfliktit, ndërkaq dy të tjerë u vranë gjatë mbulimit të protestave të dhunshme. Për të tretin vit me radhë, Kina është shteti me më së shumti gazetarë të arrestuar, shtet në të cilin janë të burgosur 50 gazetarë. Në

vendin e dytë është Mianmari për shkak të shtypjes së mediave që pasoi puçin ushtarak të shkurtit. Egjipti, Vietnamit dhe Bjellorusia gjenden në pesë shtetet me më së shumti gazetarë prapa grilave. Në mesin e shteteve që kanë përmirësim sa i përket burgosjes së gazetarëve është Turqia. Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve tha se Turqia ka liruar nga burg 20 gazetarë gjatë vitit të kaluar, ndërkaq 18 të tjerë vazhdojnë të jenë të burgosur. Raporti i Komitetit për Mbrojtjen e Gazetarëve tha se se përderisa bota gjatë vitit



2021 po përballet edhe me probleme si pandemia e koronavirusit dhe ndryshimet klimatike, qeveritë represive ishin të vetëdijshme se zemërimi i publikut ndaj

shkeljeve të të drejtave të njeriut ishte "zbutur". Të dhënat e raportit paraqesin trendin e përgjithshëm të rritjes së intolerancës ndaj raportimit të pavarur.

Zelanda e Re paraqet planin për t'i dhënë fund duhanpirjes



WELLINGTON, 9 DHJETOR - Qeveria e Zelandës së Re ka njoftuar të enjten se ka arritur të krijojë një plan unik për t'i dhënë fund pirjes së duhanit, duke paraqitur një ndalesë të përrjetshme për personat 14 vjeç apo më të rinj. Sipas ligjit të ri, që u paraqit më 9 dhjetor nga Qeveria e Zelandës së Re, që pritet të miratohet vitin e ardhshëm, moshë minimale e personave që mund të blejnë cigare do të rritej vit pas viti. Kjo

nënkupton, që 65 vjet pas hyrjes në fuqi të ligjit, qytetarët mund të blejnë cigare nëpër dyqane, por duhet të dëshmojnë se janë të paktën 80 vjeç. Plani i qeverisë ka vendosur synimin që nën 5 për qind të qytetarëve të jenë konsumues të duhanit deri në vitin 2025. Po ashtu, pjesë e planit qeveritar është edhe lejimi i shitjes së produkteve të duhanit me nivele të ulëta të nikotinës.

Sipas ligjeve aktuale në fuqi në Zelandën e Re, qytetarët e moshës 18 vjeç e lart lejohen të blejnë duhan. Sipas të dhënave, numri i personave që janë duhanpirës në Zelandën e Re ka rënë gjatë viteve të fundit dhe rreth 11 për qind e personave të rritur janë duhanpirës, ndërkaq 9 për qind e tyre tymosin duhan çdo ditë. Ndërkaq, te komuniteti indigjen Maori, përqindja e duhanpirjes është 22 për qind.

Në Francë u zbuluan planet për sulme terroriste për Krishtlindje

PARIS, 9 DHJETOR - Dy djem të moshës 23-vjeçare janë akuzuar për terrorizëm në Francë. Pas arrestimit të tyre u zbulua se kishin planifikuar të kryenin sulme me thika në hapësira publike gjatë kohës së festave të fundvitit. Shërbimi inteligjent në Francë arrestoi dy djemtë kah fundi i nëntorit në dy zona të ndryshme në periferi të Parisit. Shërbimi inteligjent pranoi

informata për planifikim të sulmeve të mundshme, tha një burim i afërt me rastin, raporton AFP. Të dytë u akuzuan për terrorizëm më 3 dhjetor dhe mbetën në paraburgim, tha burimi duke konfirmuar kështu raportimet e para të publikuara në gazetën "Le Parisien". Plani i dy të arrestuarve ishte të sulmonin njerëz në qendra tregtare dhe në rrugë.

Burimi i informuar për rastin tha se dy burrat madje diskutuan se ku do të duhej të "vdisnin si martirë", duke shtuar se plani ishte i inspiruar nga xhihadistët. Dyshja, sipas burimit, u njoh në rrjetet sociale e më pas u takua edhe fizikisht. Në Francë ndodhën shumë sulme terroriste që nga viti 2015, me ç'rast qindra njerëz vdiqën e vendi u detyrua ta rrisë nivelin e sigurisë në më të lartin.



Çekia do të vendosë 150 ushtarë në kufi në mes të Polonisë e Bjellorusisë

PRAG, 9 DHJETOR - Qeveria çeke ka miratuar shpërndarjen e së paku 150 ushtarëve të saj në kufirin me Bjellorusinë për ta ndihmuar Poloninë në frenimin e valës së migrantëve nga Bjellorusia. Sipas këtij plani të qeverisë që pritet të miratohet, Çekia do të bëhet shteti i tretë që dërgon ushtarë

në kufirin në mes të Polonisë e Bjellorusisë, shkruan "Reuters". Më herët këtë e bënë Estonia dhe Britania e Madhe. "Qeveria miratoi dërgimin e trupave për mbrojtjen e kufirit në mes të Polonisë dhe Bjellorusisë" shkroi ministri çek i Mbrojtjes në "Twitter". Ditët e fundit, megjithatë, ka



rënë numri i migrantëve nga Lindja e Mesme të cilët tentojnë të kalojnë nga

Bjellorusia në Poloni, ndërkaq roja kufitare polake më 7 dhjetor njoftoi se ka evidentuar 51 tentime. Polonia ka akuzuar shërbimet inteligjente bjelloruse për të kaluar kufirin dhe për t'i provokuar trupat polake, derisa Minsku e mohoi këtë.

Bjellorusia, po ashtu, mohon akuzat e Bashkimit Evropian që ka shkaktuar krizën me migrantë si hakmarrje ndaj sanksioneve të Perëndimit, të cilat u vendosën ndaj Bjellorusisë për shkak të shkeljes të të drejtave të njeriut pas zgjedhjeve presidenciale në vend.

Një i vdekur dhe 19 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 9 DHJETOR (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, prej 2 236 testeve, 19 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit është shënuar një rast i vdekjes. Të enjten janë shëruar edhe gjashtë qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 157 859. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 331. Në 24 orët e fundit

janë dhënë 2 999 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 636 378 doza të vaksinës. Deri më sot 769 967 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.



Osmani në Samitin për Demokraci: Kosova luftoi regjimet autoritare dhe gjenocidale

WASHINGTON, 9 DHJETOR (ER) - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Joe Biden, ka thënë se demokracia po përballet "me sfida të qëndrueshme dhe alarmante" në mbarë botën. Ai këto komente i ka bërë të enjten në nisjen e Samitit për demokracinë, një samit virtual, në të cilin po marrin pjesë liderët e 110 shteteve, përfshirë Kosovën dhe Shqipërinë.

Bideni ka thënë se në planin e brendshëm ShBA-ja ka nisur një sërë iniciativash për t'ua përmirësuar jetën amerikanëve. "Si komunitet global për demokracinë ne duhet të ngrihem për vlerat që na bashkojnë, ne duhet të ngrihem për drejtësi dhe sundim të ligjit, për liri të shprehjes, liri të tubimit, liri të medias, liri të besimit dhe për të gjitha të drejtat e njeriut", ka thënë Bideni.

Ndërsa presidentja e Kosovës,

Vjosa Osmani, ka thënë se Kosova për një kohë të gjatë ka luftuar regjimet autoritare dhe gjenocidale. "Së shpejti Kosova do të shënojë 14-vjetorin e pavarësisë, por regjimet autoritare dhe gjenocidale i kemi luftuar për një kohë shumë më të gjatë se kaq. Demokracia është në themelet e shoqërisë sonë. Ajo është e rrënjësuar thellë në luftën tonë historike për liri dhe të drejtat e njeriut. Dhe, siç e parashikoi ati ynë themeltar, presidenti Rugova, Republika jonë mbështetet fuqishëm në tri shtylla: liri, pavarësi, demokraci", ka thënë Osmani. Osmani ka përmendur edhe zgjedhjet në Kosovë, të cilat i ka përshkruar si të lira dhe demokratike, me një tranzicion paqësor të pushtetit. Kësisoj, Osmani ka shpallur tri zotimet e Kosovës në kuadër të procesit të demokratizimit të plotë, ku përfshihen sundimi i ligjit, fuqizimi i rolit të gruas si dhe



formimi i këshillit presidencial për të drejtat e njeriut. Në këtë drejtim Osmani ka përmendur edhe vettingun në drejtësi.

Ndërsa kryeministri i

Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se mbështetja e ShBA-së ishte vitale në rrugën e shtetit shqiptar drejt demokracisë. "Në këtë rrugëtim mbështetja e

ShBA-së ka qenë vitale për avancimin e aspiratave demokratike dhe forcimin e sundimit të ligjit", ka thënë Rama.

Specialja ua vazhdon paraburgimin Veselit, Krasniqit dhe Selimit



HAGË, 9 DHJETOR - Gjykata Speciale ua ka vazhduar paraburgimin ish-udhëheqësve të UÇK-së, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Lajmi u bë me dije përmes njoftimit të publikuar në faqen zyrtare të kësaj gjykate.

"Pas urdhrorit të tij drejtuar Policisë së Kosovës, më 8 tetor, si

dhe parashtrimeve nga Policia e Kosovës dhe nga palët, Gjykatësi i Procedurës Paraprake në çështjen Thaçi dhe të tjerët urdhëroi mbajtjen e mëtejshme në paraburgim të Veselit, Krasniqit dhe Selimit", thuhet në njoftim.

Më 9 nëntor, në paraqitjet e tyre të para, Jakup Krasniqi e

Hashim Thaçi janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që u vihen në barrë. Njëjtë është deklaruar edhe Veseli në paraqitjen e tij më 10 nëntor, sikurse edhe Selimi më 11 nëntor. Aktakuza ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është konfirmuar më 26 tetor 2020.

Në komunat me shumicë serbe, mbi 500 raste aktive me Covid-19

MITROVICË, 9 DHJETOR - Në komunat e Kosovës të banuara me shumicë serbe janë regjistruar 33 raste të reja me koronavirus, sipas një raporti të Shtabit të Krizës të Komunës së Mitrovicës së Veriut, të publikuar më 9 dhjetor.

Ndërkaq, numri i rasteve aktive është 508.

Komunat me shumicë serbe

nuk publikojnë rregullisht raporte lidhur me gjendjen epidemiologjike, por ato publikohen çdo dy apo tri ditë. Në raportin e fundit nuk u raportua për ndonjë viktimitë nga sëmundja Covid-19.

Më 7 dhjetor në zonat e banuara me shumicë serbe ishin raportuar dy viktima dhe 42 raste të reja me koronavirus. Institucionet shëndetësore në

komunat e banuara me shumicë serbe funksionojnë në kuadër të sistemit serb që financohet nga Beogradi.

Ndërkaq, së fundmi, Ministria e Shëndetësisë e Kosovës po raporton për numër të ulët të rasteve të reja me koronavirus. Gjatë 8 dhjetorit kjo ministri raportoi për dhjetë raste të reja dhe 319 raste aktive me koronavirus.





SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) KANË VENDOSUR NË LISTËN E SANKSIONEVE DHJETËRA SERBË TË VERIUT TË KOSOVËS

ShBA-ja sanksionon kriminelët e veriut

Zyra e Kontrollit për Pasuritë e Huaja e Departamentit të Thesarit ka goditur grupin e biznesmenit serb Zvonko Veselinoviq, duke i vënë sanksione. Dhjetëra individë të këtij grupi akuzohen për marrëveshje me politikanët në veri të Kosovës, për ta ndihmuar fitoren e tyre në zgjedhje dhe mbështetjen financiare për ta. Një veprim i tillë i ShBA-së është përshëndetur nga spektri politik i Kosovës. Institucionet e Kosovës kanë paralajmëruar se personat e sanksionuar do të hetohen edhe nga drejtësia vendore

Grupi i tij, është thënë në njoftim, është i angazhuar në një skemë ryshfeti në shkallë të gjerë me zyrtarë të sigurisë në Kosovë dhe Serbi, për ta lehtësuar trafikimin e paligjshëm të mallrave, parave, narkotikëve dhe armëve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në listë përfshihen edhe shumë kompani në Serbi dhe Kosovë,

që janë të lidhura me pjesëtarët e grupit. Në njoftim është theksuar se Zvonko Veselinoviq dhe grupi i tij janë akuzuar nën dyshimet për përfshirjen në vrasjen e politikanit lokal serb Oliver Ivanoviq në janar të vitit 2018. Zvonko Veselinoviq dhe anëtarët e tjerë të grupit të kimit të organizuar Milan

Radojçiq, Zhelko Bojiq dhe Marko Rosiq janë përmendur të gjithë në aktakuzën për vrasjen.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka vlerësuar se sanksionet janë në pajtim me objektivat e Samitit për Demokracinë, i cili ka filluar punimet të enjten nën organizimin e presidentit amerikan Joe Biden. “Ne e dimë se krimi i organizuar i mbështetur nga aktorë të korruptuar mund ta destabilizojë sundimin e ligjit, ta gërryjë besimin në institucionet publike dhe ta dobësojë qeverisjen demokratike”, është thënë në deklaratën e sekretarit Blinken.

Kosova mirëpret sanksione ndaj kriminelëve të veriut

Pas sanksioneve të ShBA-së për kriminelët e veriut, kanë reaguar të gjithë liderët institucionalë dhe politikë të Kosovës. Ata e kanë mirëpritur një veprim të tillë, duke thënë se edhe Kosova është e përkushtuar për sundim të rendit dhe ligjit në vend. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka përshëndetur

BE-ja dhe Britania e Madhe mbështetin sanksionet kundër grupit të Veselinoviqit

Bashkimi Evropian dhe Britania e Madhe u kanë dhënë mbështetje sanksioneve të ShBA-së kundër grupit kriminal në veri të Kosovës. Shefi i diplomacisë i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, në llogarinë e vet në “Twitter” ka shkruar se ky është hap i rëndësishëm në luftën kundër kimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor. “Shkatërrimi i rrjeteve kriminale transnacionale kontribuon në sigurinë, stabilitetin dhe përmirëson sundimin e ligjit në mbarë rajonin. BE-ja është plotësisht e angazhuar për arritjen e këtij synimi të përbashkët”, ka shkruar Borrell.

Kurse ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Nicholas Abbott, ka deklaruar se ky veprim është në interes për të gjitha komunitetet në Kosovë. “E mirëpres vendimin e Shteteve të Bashkuara për të vendosur sanksione kundër individëve të përfshirë në krim të organizuar dhe korrupsion. Ky është në interes të të gjitha komuniteteve në Kosovë”, ka shkruar Abbott në llogarinë e vet në “Facebook”.

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Në vazhdim të angazhimit të ShBA-së për ta luftuar korrupsionin në rajonin e Ballkanit Perëndimor, Departamenti Amerikan i Thesarit ka shenjëstruar edhe një grup të kimit të organizuar i cili vepron në veri të Kosovës. Në njoftimin e Departamentit Amerikan të Thesarit, Zvonko Veselinoviq identifikohet si udhëheqës i grupit të kimit të organizuar dhe, gjithashtu, si një nga figurat më famëkeqe të korrupsionit në Kosovë. Përveç Zvonko Veselinoviqit dhe vëllait të tij, Zharko Veselinoviq, në listë janë Zhelko Bojiq, Milan Mihajloviq,

Sinisha Nedeljkoviq, Radovan Radiq, Milan Radisavleviq, Miloško Radisavleviq, Milan Radojçiq, Marko Rosiq, Radule Steviq dhe Milivoje Vuloviq. Sipas njoftimit, grupi akuzohet, pos të tjerash, për marrëveshje me politikanët në veri të Kosovës, për ta ndihmuar fitoren e tyre në zgjedhje dhe mbështetjen financiare për ta. Në këmbim, politikanët do t'u jepnin vëllezërve kontratat më të mira të infrastrukturës dhe kontrollin e zonave të caktuara për bizneset e tyre. Milan Radojçiq, që është pjesë e grupit, është një nga drejtuesit e Listës Serbe, subjektit kryesor politik të serbëve të Kosovës, i cili është themeluar dhe mbështetur nga Serbia.

Kurti: Reformimi i prokurimit publik, ndër pikat më të rëndësishme në luftimin e korrupsionit



PRISHTINË, 9 DHJETOR (ER) - Në Ditën Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit nuk ka ditë më të mirë sesa të flasim për prokurimin publik, si një nga burimet e mëdha të korrupsionit. Kështu ka thënë kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, në fillim të fjalës së tij, në shënimin e kësaj dite, ku është përmbyllur edhe aktiviteti i USAID-it - "komuna transparente, efektive dhe

llogaridhëse në Kosovë". Kurti ka thënë se për qeverinë reformimi i prokurimit publik është ndër pikat më të rëndësishme në luftimin e korrupsionit dhe parandalimin e keqpërdorimit të parasë publike. "Në vitet e mëhershme ai përbënte një të tretën e buxhetit, dhe ndonëse volumi i prokurimit mund të jetë më i ulët këtë vit si rezultat i analizimit të shumë tenderëve

dhe projekteve gjatë vitit paraprak, vitin tjetër ai mund të rritet me më shumë vepra publike, me çerdhe të reja, me rrugë e infrastrukturë përcjellëse për urbanizimin e qyteteve dhe ringjalljen e fshatrave", ka thënë Kurti, duke shtuar se transparenca është esenciale për luftimin e kësaj dukurie negative. "Ne kemi mbi 180 autoritete kontraktuese të cilat janë shumë për një shtet

relativisht jo të madh. Ne duhet ta rishikojmë domosdoshmërinë e të gjithë këtyre autoriteteve kontraktuese sepse sa më shumë që janë aq më shumë hapësirë për kontraktime, të cilat mund t'i ikin mbikëqyrjes, por edhe që rezultojnë me blerje me çmime të ndryshme për produkte të njëjta. Shumë shërbime e kontraktime mund të bëhen me shumëfish më pak autoritete kontraktuese.

KRPP-ja është autoritet rregullativ, por duhet të jetë më efektiv në monitorim, përcaktimin e rregullave dhe bashkëpunimin me institucione të tjera. Institucione të rëndësishme të cilat janë të lidhura direkt me prokurimin nuk po konsiderohen pjesë e këtij procesi. Këtu e kam fjalën për Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve - ARBK-në, Administratën Tatimore të Kosovës, por edhe gjykatat. Skandale të shumta kanë bërë që të bie besimi në OShP, diçka që shprejsojmë që bordi i ri i ardhshëm ta korrigjojë, por askush nuk duhet ta marrë ligjin në duar dhe askush nuk duhet t'i ikë përgjegjësisë dhe llogaridhënies. Transparenca në këtë drejtim është çelës", ka thënë Kurti.

Ndërsa Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) nëpërmjet një komunikate për media ka kërkuar nga institucionet vendore që të bëhen bashkë për luftimin e kësaj dukurie negative. Po ashtu, KDI-ja ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që ta procedojë në Kuvend pakon e ligjeve kundër korrupsionit. "Kërkojmë nga institucionet vendore që, në vend se ta drejtojnë gishtin nga njëra-tjetra në kërkim të fajtorit për mungesë të sundimit të ligjit dhe nivelin e lartë të korrupsionit, të bëhen bashkë në një front të vetëm në luftë kundër korrupsionit", është thënë në komunikatën e KDI-së.

I jepet lumturia e fundit babait të heroit Enver Zymberi

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Të enjten i është dhënë lamtumira e fundit Muharrem Zymberit, babait të heroit të Kosovës, Enver Zymberi. Në ceremoninë e varrimit ka marrë pjesë edhe kryeministri Albin Kurti. Muharrem Zymberi, i cili ishte edhe veteran lufte dhe i burgosur politik, është kujtuar nga kryeministri Kurti si njeri i dashur, bujar, punëtor, i

guximshëm e i qëndrueshëm. "Në burg ishte i pathyeshëm dhe të gjithë që e kanë njohur, kanë marrë forcë prej tij. Pavarësisht se nuk dihej çka do të ndodhte të nesërmen, buzëqeshja dhe trimëria në asnjë situatë nuk i kanë munguar Muharrem Zymberit", ka thënë kryeministri, duke folur për kohën kur të dy ishin të burgosur politikë në Burgun e Pozharevcit.

Ai ka thënë se janë pikërisht njerëzit si Muharrem Zymberi që e shtojnë përpara edhe shtetin e Kosovës dhe kombin shqiptar. "Tash jemi këtu pranë varrit edhe të Enverit edhe të Muharremit dhe padyshim se te kjo familje, e cila i dha shumë edhe luftës edhe paqes, do të rikthehem përherë për shkak se i kemi obligim e borxh për kontributin e tyre", ka thënë Kurti.



veprimin e ShBA-së. "Institucionet e Kosovës janë plotësisht të përkushtuara për sundimin e ligjit dhe do të bashkëpunojnë me Shtetet e Bashkuara për të siguruar që rajoni ynë të mos bëhet një parajsë për grupe të tilla kriminale", ka shkruar ajo në llogarinë e vet në "Twitter". Kurse kryeministri i Kosovës,

Albin Kurti, ka paralajmëruar se personat e sanksionuar do të hetohen edhe nga institucionet e drejtësisë së Kosovës. "Ne e kemi mirëpritur, është një vendim shumë i mirëseardhur, i cili po tregon që krimi dhe korrupsioni nuk duhet të kenë vend jo vetëm në vendet e BE-së, por në çdo vend që aspiron

të bëhet anëtar i BE-së si puna e Kosovës. Por, ajo çfarë duhet të bëhet në vijim, e kjo është punë e jona, është që sistemi i drejtësisë t'i përcjellë me vëmendje të gjitha vendimet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës që kanë informacion të bollshëm, në mënyrë që ata të mos kenë vetëm sanksione nga ShBA-ja, por të jenë të

sanksionuar, hetuar, gjykuar e dënuar edhe këtu te ne", ka deklaruar Kurti të enjten. Ndaj vendimit ka reaguar edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. "Vendimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për sanksionimin e krerëve të krimit të organizuar në Kosovë është lajm i shkëlqyeshëm për Kosovën. ShBA-ja dhe Kosova

janë të përkushtuara për sundimin e ligjit dhe kjo është një përpjekje e përbashkët për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. Vendimi do ta ndihmojë misionin tonë të përbashkët për ta goditur krimin transnacional në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor", ka shkruar ai në llogarinë e vet në "Facebook".

Haziri ia dorëzon Alban Hysenit detyrën e kryetarit të Gjilanit

GJILAN, 9 DHJETOR - Lutfi Haziri nga Lidhja Demokratike e Kosovës ia ka dorëzuar të enjten zyrtarisht Alban Hysenit të Lëvizjes

Vetëvendosje detyrën e kryetarit të komunës së Gjilanit. Me këtë rast, Haziri ia ka dorëzuar Hysenit edhe dosjet e projekteve, duke

theksuar se kryetari i ri tashmë do të përballet me problemet e gjilanasve. Hyseni, duke e falënderuar Hazirin për pritjen, ka thënë

se ndryshimet që dalin nga zgjedhjet demokratike sjellin freski. Madje ai ka theksuar se janë për bashkëpunim për të mirën e qytetarëve.



Syla, thirrje Kurtit: Mos e vështirëso jetën e çlirimtarëve!

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Kryetari i OVLUÇK-së në Pejë dhe ish-drejtor i Zyrës për Çështjen e Kategorive të Dala nga LUFTA e UÇK-së, Gazmend Syla, ka thënë se veteranët e luftës po vdesin e familjet e tyre po keqtrajtohen nga Zyra për Çështjet e Kategorive pranë zyrës së kryeministrit e cila e ka për obligim t'u shërbejë. Atyre nuk u mundësohet të marrin as 119 euro pension që u takon. Syla përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka thënë se familjet e veteranëve të luftës të cilët kanë vdekur nuk po i marrin pensionet për shkak të gabimeve teknike në emërtimin e vendbanimit. "Gruaja e luftëtarit

të vdekur, me katër fëmijë jetimë, nuk ka mundësi ta marrë pensionin e burrit të ndjerë për shkak të gabimeve teknike të llojit 'Trestenik - Terstenik', 'Logjë - Loxhë', apo 'Baran - Baranë'. Zyra për Çështjet e Kategorive të Dala nga Lufta në Zyrën e Kryeministrit, në vend se t'i korrigjojë këto gabime, ka kthyer prapa me dhjetëra raste si ai që e cekëm më lart", ka shkruar Syla.

Ai ka thënë se gabime të kësaj natyre ka në secilin institucion, porse ato janë rregulluar nga zyrtarët. "Probleme teknike ka në secilin institucion, edhe në zyrën në fjalë, por gjithëherë janë rregulluar nga zyrtarët deri para ardhjes së qeverisë Kurti. E kanë shumë të lehtë. Numri unik personal, që e ka secili qytetar i



Kosovës, nuk lë vend për gabime. Shumë luftëtarë të UÇK-së u mashtruan dhe e votuan Kurtin, e me këtë mundësuan që njerëzit e papërgjegjshëm e pandërgjegjshëm të punojnë në Zyrën e Kategorive të Lirisë. Sot u bëj thirrje atyre, që t'i flasin e ta bindin kryeministrin që e sollën në pushtet, që të lehtësojë e jo të vështirësojë jetën e familjeve të bashkëlufëtarëve të tyre të vdekur", është shprehur Syla. Ai i ka pyetur zyrtarët shtetërorë nëse ata po i marrin pagat. "Veteranët po vdesin, e familjet e tyre po keqtrajtohen nga zyra e cila e ka për obligim t'u shërbejë. Atyre nuk u mundësohet të marrin as 119 euro pension që u takon. Po ju zyrtarë, a po i merrni pagat me kohë?", ka pyetur Syla.

Vesa Broja zgjedhet kryesuese e Kuvendit Komunal në Mitrovicë



MITROVICË, 9 DHJETOR (ER) - Nën drejtimin e anëtarit më të moshuar të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës, Fadil Veseli, dhe në prani të kryetarit të komunës, Bedri Hamza, nënkryetarit Arian Tahiri, është mbajtur mbledhja e rregullt e kuvendit për zgjedhjen e kryesuesit të KK-së.

Anëtarit më i moshuar i kuvendit, Fadil Veseli, ka propozuar edhe rendin e ditës për këtë seancë, ku pas formimit të komisionit prej tre anëtarësh për zgjedhje të kryesuesit, me vota të fshehta, kryesuese u zgjodh Vesa Broja nga Partia Demokratike e Kosovës, e cila fitoi 21 vota nga të

gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës sa ishin të pranishëm në këtë seancë.

Pas kësaj me një fjalë rasti të pranishmëve u është drejtuar kryesuesja e Kuvendit, Vesa Broja, e cila ka thënë se do të bashkëpunojë ngushtë me të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe se është e përkushtuar për të punuar për çështje që kanë të bëjnë me qytetarët dhe të mirën e komunës.

Ndërsa pika e dytë e rendit të ditës, e paraparë për këtë seancë, propozim-vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, është shtyrë për mbledhjen e radhës të kuvendit.

Kastrati: Malisheva, shembull për ofrimin e shërbimeve shëndetësore

MALISHEVË, 9 DHJETOR (ER) - Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, të enjten e ka vizituar Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) "Dr. Shpëtim Robaj" në Malishevë, ku është njoftuar punën e profesionistëve shëndetësorë si dhe është zotuar se do ta përkrahë këtë qendër të mjekësisë për rritjen e kapaciteteve me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më të mira për

pacientët. "Vizitën e parë në cilësinë e kryetarit të komunës së Malishevës sot e bëra në Qendrën Kryesore e Mjekësisë Familjare 'Shpëtim Robaj' në Malishevë, për të parë nga afër punën fisnike që po bëhet nga stafi mjekësor, si dhe për të bashkëbiseduar me stafin menaxherial për sfidat dhe nevojat që ka ky institucion", ka thënë kryetari Kastrati, duke shtuar se si kryetar i Malishevës do të jetë adresa kryesore e

përkrahjes së këtij institucioni. "Për asnjë moment nuk do të ndalemi derisa secila qendër shëndetësore në komunën tonë të ketë kushte moderne infrastrukturore dhe rritje të kapaciteteve të burimeve njerëzore në mënyrë që qytetarët tanë të marrin në kohën e duhur shërbime shëndetësore cilësore", ka deklaruar kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, gjatë vizitës së tij në QKMF në Malishevë.



Unaza e kombit Tiranë - Shkup - Prishtinë shumë shpejt pritet të bëhet realitet

SHKUP, 9 DHJETOR (ER) - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka bërë me dije të enjten se Unaza e kombit Tiranë - Shkup - Prishtinë shumë shpejt do të

bëhet realitet. "Kënaqësi të ndaj me ju lajmin e madh se Korridori 8 dhe Korridori 10 nuk kanë më asnjë pengesë juridike në rrugën e realizimit të tyre. Gjykata Kushtetuese

dha sot verdiktin e saj final për korrektësinë juridike të procedurës së realizimit të projektit më të madh infrastrukturor në historinë e vendit me kompaninë e

mirënjohur të ndërtimit 'Bechtel - Enka'. Unaza e kombit Tiranë - Shkup - Prishtinë, shumë shpejt realitet", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".



Ministri i Shëndetësisë nuk takohet me specializantët, këta paralajmërojnë vazhdimin e protestave

Specializantët e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) kanë protestuar të enjten para Ministrisë së Shëndetësisë (MSh), pasi kërkesa e tyre që t'u paguhen orët e kujdestarive është refuzuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Para objektit të Ministrisë së Shëndetësisë me dhjetëra mjekë kanë protestuar të enjten duke shprehur pakënaqësi me trajtimin qeveritar.

Specializantët me financim të rregullt po kërkojnë paga për orët e kujdestarive, ndërsa specializantët me vetëfinancim po kërkojnë përfshirje në Ligjin për Paga dhe transferimin në specializantët të rregullt. Ndonëse janë duke kërkuar tash e një kohë të gjatë që të takohen

me kryeministrin Albin Kurti dhe ministrin e Shëndetësisë, Rifat Latifi, kjo kërkesë nuk u është realizuar as të enjten. Gjatë protestës kryetari i Këshillit të Specializantëve, Arianit Zajmi, si dhe dy nga përfaqësuesit e specializantëve, Uran Halimi dhe Dion Musliu, janë ftuar në takim, mirëpo në takimin e zhvilluar në korridorin e Ministrisë, përfaqësuesit kanë treguar se i ka pritur vetëm një nga këshilltarët e ministrit. Pas takimit, anëtari i Këshillit të

Specializantëve, njëherësh specializant i Ortopedisë, Dion Musli, është shprehur i shqetësuar për faktin se as sot nuk kanë arritur të takohen me ministrin Latifi, prandaj kanë paralajmëruar se protesta do të vazhdojë të enjten e javës së ardhshme, nëse deri atëherë nuk arrijnë të kenë një takim me ministrin. Të enjten është mbajtur protesta e dytë e specializantëve para objektit të Ministrisë së Shëndetësisë. Në korrik të vitit të kaluar Ministria e Shëndetësisë

në krye me Armend Zemaj hapi konkursin për shkollim specialistik në nivel vendi. Procesi i specializimit të mjekëve nuk ishte bërë për katër vjet. Në atë konkurs kishin aplikuar mbi 1 000 mjekë. Ndarja e buxhetit për specializantët me vetëfinancim bëhet në kuadër të ndarjeve të subvencioneve, por jo nga buxheti i rregullt i Qeverisë së Kosovës, ndërsa kërkesa e specializantëve me vetëfinancim është që të hyjnë në paga të rregullta.



Mehmet Kraja rizgjedhet kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës



PRISHTINË, 9 DHJETOR (ER) - Shkrimtari Mehmet Kraja e ka fituar edhe një mandat në krye të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Atij iu besua vazhdimi i kësaj detyre në Kuvendin e Rregullt Zgjedhor që u mbajt të enjten. "Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 9 dhjetor 2021, mbajti zgjedhjet e rregullta të

udhëheqjes së Akademisë dhe zgjedhi kryesinë e re të Akademisë: 1. Akademik Mehmet Kraja, kryetar; 2. Akademike Justina Sh. Pula, nënkryetare; 3. Anëtar korrespondent Luan Mulliqi, sekretar shkencor. Kuvendi i Akademisë, gjithashtu, miratoi zgjedhjen e sekretarëve të seksioneve: 1. Akademik Sabri Hamiti, sekretar i Seksionit të

Gjuhësisë dhe të Letërsisë; 2. Anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore; 3. Anëtar korrespondent Fetah Podvorica, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës. Akademik Rauf Dhomi u caktua ushtrues i detyrës së sekretarit të Seksionit të Arteve", ka njoftuar AShAK-u.



56 për qind e bizneseve të anketuara mendojnë se korrupsioni në prokurim publik është i pranishëm

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Lëvizja FOL të enjten ka publikuar gjetjet nga hulumtimi "Perceptimet e sektorit privat rreth prokurimit publik".

Yllka Buzhala nga FOL tha se "për ta marrë vlerësimin dhe perceptimin e përvojave të bizneseve rreth prokurimit publik në Kosovë janë realizuar 150 anketa. Nga këto biznese, 95 ishin pjesëmarrëse në prokurim publik dhe 55 prej tyre nuk ishin". Sipas saj, bizneset e anketuara aktualisht konsiderojnë se situata pandemike (67 për qind) është një ndër sfidat kryesore me të cilat ata po ballafaqohen.

E dyta me radhë përmendet mungesa e investimeve të huaja (14 për qind), pastaj vjen korrupsioni (9 për qind), mungesa e fuqisë punëtore (8 për qind) dhe burokracia e institucioneve (6 për qind).

Megjithëse nuk e konsiderojnë korrupsionin si sfidën kyçe

aktualisht, afërsisht një në katër prej tyre mendojnë se trajtimi i favorshëm në procedura të hapura (28 për qind), përsheptimi i një procedure burokratike (26 për qind), shmangia e dënimeve (23 për qind) janë arsyt që i shtyjnë bizneset të përfshihen në korrupsion.

Ardi Shatri nga FOL ka thënë se mbi gjysma e bizneseve (56 për qind) po ashtu mendojnë se korrupsioni në prokurim publik është i pranishëm. Sipas tij, nga këto biznese rreth një në tre mendojnë se faktorët që lehtësojnë ndikimin e korrupsionit në prokurim publik janë pandëshkueshmëria (35 për qind), zvarritja e proceseve gjyqësore (32 për qind) dhe mosraportimi i korrupsionit (32 për qind). Po sipas tij, më pak mendojnë se zbrazëtitë ligjore (20 për qind), apo mungesa e vullnetit politik (19 për qind) lehtësojnë korrupsionin.

Shatrit ka treguar se disa praktika negative që ndikojnë në

procesin e prokurimit publik janë përshtatja e specifikave tenderuese për kompani të caktuara, paqartësia e informatave në tenderë, abuzimi me dispozita ligjore për përfitime apo edhe konflikti i interesit. "Nga këto praktika, bizneset e anketuara besojnë se më e përhapur është përshtatja e specifikave tenderuese (45 për qind)", ka thënë ai.

Lidhur me perceptimet se prokurimi publik është i lidhur me apo zhvillohet në përputhje me partitë politike në pushtet, 25 për qind e bizneseve pohojnë se bizneset që fitojnë tenderë ndryshojnë ndonjëherë pas ardhjes së një ministri/eje apo kryetari/e të ri në pushtet, e 27 për qind mendojnë se ndryshojnë shpesh ose pothuajse gjithmonë. Ngjashëm, rreth 31 për qind mendojnë se aktorët politikë që tregojnë mirënjohje për bizneset që i kanë dhuruar para partisë apo kandidatit për fushatë shpërblehen me kontrata prokurimi pas fitimit të

zgjedhjeve dhe 24 për qind mendojnë se kjo ndodh ndonjëherë.

Sipas këtij hulumtimi, shumica e bizneseve pjesëmarrëse në prokurim publik kishin fituar tenderë disa herë dhe në vlera të ndryshme. "Mbi gjysma e tyre (53 për qind) u shprehën se kanë hasur në raste kur specifikat e tenderit janë përshtatur për biznese të caktuara, kurse 31 për qind e tyre kanë deklaruar se kanë pasur raste kur oferta e tyre për tenderim u është refuzuar disa herë", ka deklaruar Shatri. Nga bizneset që deklarojnë se u janë refuzuar ofertat, vetëm 18 për qind e tyre kanë ndërmarrë hapa të ndryshëm sikurse të ankohen në OShP (26 prej tyre), të bëjnë kërkesë për rishqyrtim të tenderit (13 prej tyre), apo të bëjnë ankesë tek autoriteti kontraktues (11 prej tyre).

Ndërkaq sa i përket asaj se sa nga bizneset e njohin Organin Shqyrtues të Prokurimit, Ardi Shatri ka thënë: "Rreth 61 për qind e bizneseve që e njohin Organin Shqyrtues të Prokurimit

(OSHP-në) mendojnë se ky organ funksionon si duhet". Nga ato biznese që e përdorin E-prokurimin, 58 për qind e bizneseve janë shumë të kënaqura me sistemin elektronik të prokurimit; 61 për qind e bizneseve janë shumë të kënaqura me ndërveprimin me E-prokurimin; 59 për qind e bizneseve janë shumë të kënaqura me funksionalitetin e dorëzimit të ofertës për tender dhe po aq biznese janë shumë të kënaqura me lehtësinë e gjetjes së tenderëve për të cilët janë të interesuar", është shprehur Shatri.

Sipas gjetjeve të kësaj ankete, duket se bizneset janë të ndara në dysh rreth përshypjeve të tyre mbi prokurimin publik në të shumtën e rasteve që anketa ka shtjelluar. Shatri ka pohuar se gjetjet tregojnë se ka ende shumë hapësirë për t'i përmirësuar proceset në prokurimin publik dhe për ta rritur vetëdijen e bizneseve mbi mekanizmat ligjorë që ekzistojnë për rregullimin e prokurimit publik.

Gati në përfundim plani për hekurudhën Prishtinë - Durrës



PRISHTINË, 9 DHJETOR - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka bërë me dije të enjten se janë në përfundim të planit për hekurudhën Prishtinë - Durrës, e cila, sipas tij, do ta vendosë Kosovën në qendër tranziti rajonal për mallrat. Në një konferencë për medie, Aliu ka thënë se pas memorandumit të bashkëpunimit me Shqipërinë dhe vizitës në Itali, kjo hekurudhë po e merr

rrugën e vet. Ai ka theksuar se shumë shpejt do të bëhet studimi i fizibilitetit ku dalin në pah koha, kostoja dhe traseja e hekurudhës. "Ky projekt po e merr rrugën e vet dhe jemi në faza kur mund ta hartojmë planin, i cili përfundon shpejt dhe do të na japë qartë afatet kohore dhe koston për këtë projekt. Pas studimit të fizibilitetit do të jetë e qartë edhe traseja e kësaj hekurudhe. Ne kemi ndarë një milion euro për këtë studim", është shprehur Aliu.

Për qeveritë e Shqipërisë dhe të Kosovës, hekurudha e planifikuar Durrës - Prishtinë ka edhe rëndësi gjeopolitike, jo vetëm ekonomike.

Kryeministri Albin Kurti pati deklaruar se linja hekurudhore Durrës - Prishtinë "është sa e një rëndësie ekonomike po aq edhe gjeopolitike, pasi ndihmon edhe rajonin, fqinjët tanë, me të cilët kemi të kaluar të përbashkët, por edhe do të ndajmë të ardhmen".

Jetët tona në shitje: Pse tregu s'duhet të ndërhyjë tek morali i një shoqërie

Nga Michael J.SANDEL
"The Atlantic"

Ka disa gjëra që s'mund të blihen me para. Edhe pse sot kanë mbetur shumë pak të tilla.

Kjo pasi sot është në shitje pothuajse gjithçka. Le të marrim disa shembuj.

Një qeli moderne: 90 dollarë nata. Në Santa Ana, Kaliforni, dhe disa qytete të tjera në Shtetet e Bashkuara, kriminelët jo shumë të dhunshëm mund të paguajnë për një qeli të pastër dhe të qetë, ku nuk shqetësohen nga të burgosurit e tjerë.

Qasja në korsitë e rezervuara për shoferët që udhëtojnë vetëm: 8 dollarë. Mineapolisi, San Diego, Hjuston, Siatëll dhe qytete të tjera të Amerikës, janë përpjekur që ta reduktojnë trafikun duke lejuar udhëtarët e vetëm të kalojnë në korsitë e veçanta, ku tarifat ndryshojnë në bazë të trafikut.

Shërbimet e një nëne surrogate indiane: 8 mijë dollarë. Çiftet përëndimore që kërkojnë mitra me qira, po fokusohen gjithnjë e më shumë tek India, ku çmimet janë më pak sesa një e treta e atyre në SHBA.

E drejta për të emetuar 1 ton dioksid karboni në atmosferë: 10.5 dollarë. Bashkimi Evropian drejton aktualisht një treg të emetimeve të karbonit, që u jep mundësinë kompanive të blejnë dhe shesin të drejtën për të ndotur.

E drejta për të emigruar në Shtetet e Bashkuara: 500 mijë dollarë. Të huajt që investojnë 500.000 dollarë, dhe hapin të paktën 10 vende pune me kohë të plotë në një zonë me papunësi të lartë, kanë të drejtën të fitojnë të drejtën e banimit të përhershëm në SHBA.

Jo të gjithë mund t'i përballojnë këto gjëra. Por sot ka shumë mënyra të reja për të fituar para. Kështu, nëse keni nevojë të bëni para shtesë, ja ku janë disa alternativa origjinale:

Marrja me qira e ballit të dikujt për të shfaqur një reklamë komerciale: 10 mijë dollarë. Në Utah, SHBA, një nënë beqare që kishte nevojë për para për të paguar studimet e të birit, mori 10.000 dollarë nga një kazino në internet, për të bërë tatuazh të përhershëm në ballin e saj adresën e internetit të kazinosë.

Të jesh një kavië njerëzore në testet e ilaçeve për një kompani farmaceutike: 7500 dollarë. Paga mund të ndryshojë në varësi të invazivitetit të procedurave të përdorura për testimin e efekteve të barnave, dhe shqetësimin e shkaktuar prej tyre.

Angazhimi si mercenar në luftimet në Somali apo Afganistan për një kompani



ushtarake private: deri në 1mijë dollarë në ditë. Paga ndryshon në bazë të kualifikimeve, përvojës dhe kombësisë.

Zënia e radhës për një natë në Kapitol Hill, për t'i mbajtur vendin një lobisti që dëshiron të marrë pjesë në një seancë dëgjimore në Kongres: 15-20 dollarë në orë. Disa kompani e ofrojnë këtë shërbim, duke punësuar edhe njerëzit e pastrehë.

Lexoni një libër në këmbim të pagesës: 2 dollarë. Për të promovuar leximin, shkollat paguajnë fëmijët për çdo libër që lexojnë.

Zgjedhje e qëllimshme

Ne jetojmë në një epokë, ku thuhet çdo gjë mund të blihet dhe shitet. Gjatë 3 dekadave të fundit, tregjet – dhe vlerat e tregut – e kanë sunduar jetën tonë si kurrë më parë. Por ne nuk arritëm në këtë gjendje përmes një zgjedhje të jo të qëllimshme, përkundrazi. Pas Luftës së Ftohtë, tregjet dhe teoritë e tregut gëzonin një prestigj të padiskutueshëm.

Asnjë sistem tjetër i organizimit të prodhimit dhe i shpërndarjes së mallrave, nuk është dëshmuar aq efektiv në krijimin e pasurisë dhe mirëqenies. Por, teksa një numër në rritje vendesh adoptuan mekanizmat e tregut për funksionimin e ekonomisë, po ndodhte diçka tjetër.

Vlerat e tregut, morën një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në shoqëri, dhe ekonomia u bë një domen perandorak. Sot logjika e blerjes dhe shitjes, nuk zbatohet më vetëm për të mirat materiale, por dikton jetën e njerëzve në tërësinë e saj, dhe në një masë gjithnjë e më të madhe.

Vitet para krizës së 2008-ës, ishin

një epokë e ekzaltimit të besimit tek tregje dhe e lehtësimit të rregulloreve, një epokë e triumfalizmit të tregut. Kjo periudhë nisi në fillim të viteve 1980, kur Ronald Regan dhe Margaret Theçer shpallën besimin e tyre se tregjet, dhe jo qeveritë, mbanin në dorë çelësat e mirëqenies dhe lirisë.

Ky besim vazhdoi në vitet 1990 me mendimin liberal të Bill Klintonit dhe Toni Blerit. Por sot ky besim po lëkundet. Kriza ka ngjallur jo vetëm dyshime mbi aftësinë e tregjeve për tashpërndarë në mënyrë efektive rrezikun. Ajo ka krijuar perceptimin e përhapur të distancimit të tregjeve nga morali, dhe nevojën për t'i afruar ato në një farë mënyre.

Por nuk është e qartë se çfarë do të thotë e gjithë kjo, apo çfarë duhet të bëjmë. Disa argumentojnë se dobësia morale në zemër të triumfalizmit të tregut u shkaktoi nga lakmia, e cila çoi në marrjen në sy të rreziqeve të mëdha.

Sipas këtij këndvështrimi, zgjidhja është të frenohet lakmia, të kërkohe më shumë integritet dhe llogaridhënie nga bankierët e Wall Street, dhe miratimi i rregullave të arsyeshme për të parandaluar përsëritjen e krizës së 2008-ës. Por kjo është në rastin më të mirë një diagnozë e pjesshme.

Është sigurisht e vërtetë që lakmia luajti një rol në krizë, por në lojë është diçka më e madhe. Ndryshimi më i madh i 30 viteve të fundit nuk ka qenë rritja e lakmisë, por shtrirja e tregjeve dhe e vlerave të tregut në sfera të jetës që tradicionalisht udhëhiqen nga norma të ndryshme.

Një shoqëri ku gjithçka është në shitje, duhet të na shqetësojë

seriozisht për 2 arsye. E para ka të bëjë me pabarazinë, dhe tjetra me korrupsionin. Le të shqyrtojmë së pari pabarazinë. Në një shoqëri ku gjithçka është në shitje, jeta është më e vështirë për ata që zotërojnë mjete modeste.

Sa më shumë gjëra që mund të blejnë paratë, aq më shumë kanë rëndësi paratë (ose mungesa e tyre). Nëse avantazhi i vetëm i pasurisë do të ishte aftësia për të blerë jahte, makina sportive dhe pushime ekskluzive, pabarazitë e të ardhurave dhe pasurisë do të kishin më pak rëndësi se sa kanë sot.

Por ndërsa paratë blejnë gjithnjë e më shumë gjëra, shpërndarja e të ardhurave dhe e pasurisë po merr një rol shumë më të rëndësishëm. Arsyeja e dytë pse duhet të hezitohet të nxjerrim gjithçka në shitje, është më komplekse. Problemi nuk qëndron tek pabarazia dhe barazia, por tek efektet gërryese të tregjeve.

Vendosja e një çmimi për gjërat që kanë rëndësi në jetë, mund t'i korruptojë ato. Pasi tregjet nuk shpërndajnë vetëm mallra, por shprehin dhe promovojnë qëndrime të caktuara ndaj mallrave që tregtohen. Kështu pagimi i fëmijëve për të lexuar libra, mund t'i motivojë ata të lexojnë më shumë, por ndërkohë mund t'i mësojë ata ta shohin leximin si një punë, dhe jo si një burim kënaqësie të brendshme.

Nga ana tjetër punësimi i mercenarëve të huaj për të zhvilluar luftërat tona, mund të shpëtojë jetën e qytetarëve tanë, por ndërkohë mund të komprometojë kuptimin e shtetësisë. Shpesh, ekonomistët supozojnë se tregjet janë inerte, domethënë se nuk kanë pasojë


për mallrat që shkëmbejnë. Por kjo nuk është e vërtetë. Tregjet lënë gjurmët e tyre. Vlerat e tregut, përjashtojnë ndonjëherë vlera të tjera që mund të ia vlen të merren parasysh. Shembulli më i dukshëm është njeriu. Skllavëria është e tmerrshme, pasi ajo i trajton njerëzit si një mall që shitet dhe blihet në një ankand. Ky trajtim, nuk i konsideron qeniet njerëzore si njerëz që meritojnë dinjitet dhe respekt, por si mjete fitimi dhe objekte që duhen përdorur. Kjo është e vërtetë edhe në raste të tjera.

Rëndësia e moralit

Debati i madh që i mungon sot politikës, është ai i rolit dhe shtrirjes së tregjeve. Duam një ekonomi tregu apo një shoqëri tregu? Çfarë roli duhet të luajnë tregjet në jetën publike dhe në marrëdhëniet personale? Si mund të vendosim se cilat mallra do të blihen dhe shitin, dhe cilat do të rregullohen nga vlera jo të tregut?

Në mënyrën e vet, logjika e tregut e zbrast jetën publike nga argumenti moral. Një pjesë e joshjes që kanë tregjet, është se ato nuk gjykojnë preferencat që kënaqin. Nëse dikush është i gatshëm të paguajë për seksin apo për një veshkë, dhe një i rritur e pranon këtë, pyetja evetme që bën ekonomisti është: "Me çfarë çmimi?"

Tregjet nuk qortojnë, ato nuk bëjnë dallime midis preferencave të lavdërueshme dhe të neveritshme. Një debat mbi kufijtë moralë të tregjeve, mund të na lejojë si shoqëri, që të vendosim se ku janë dhe ku nuk duhet të jenë tregjet të dobishme për të mirën e përbashkët.



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

KOK-u ndau shpërblimet për LO 'Tokyo 2020' dhe nënshkroi Bursat Olimpikë 'Paris 2024'

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Me rastin e shtatëvjetorit të anëtarësimit të Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK) në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar (IOC), KOK-u organizoi ceremoninë e ndarjes së shpërblimeve për sportistët pjesëmarrës në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020" dhe ndarjen e pikëve të dërguara nga IOC, si dhe nënshkrimin e Bursave Olimpikë për Lojërat Olimpikë "Paris 2024". Të pranishëm në ceremoninë e organizuar në hotelin "Swiss Diamond", krahas drejtuesve të KOK-ut, presidentit Ismet Krasniqi, sekretarit të përgjithshëm Besim Aliti dhe anëtarëve të Bordit Ekzekutiv, ishin edhe ministri për Kulturë, Rini dhe Sport, Hajrullah Çeku, u. d. i drejtorit në Departamentin e Sportit në MKRS, Fikret Shatri, trajneri tri herë kampion olimpik, Driton Kuka, kampionia olimpikë Nora Gjakova, sponsorë të KOK-ut etj. KOK-u shpërbleu me nga 10 mijë euro kampionet olimpikë, Nora Gjakova e Distria Krasniqi, me 5 mijë euro trajnerin Driton Kuka dhe me nga 500 euro të gjithë sportistët pjesëmarrës. Presidenti Krasniqi, duke uruar për 7-vjetorin, theksoi se anëtarësimi në IOC ua hapu rrugën sportistëve tanë që sot

vendi ynë të ketë tri medalje të arta olimpikë, derisa u ndal te suksesi i fundit, ai i Lojërave Olimpikë Tokio 2020 dhe rruga drejt Paris 2024. "Sot po e mbyllim ciklin e LO 'Tokio 2020' me dhënien e pikëve të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe ndarjen e shpërblimeve prej 500 deri në 10 mijë euro, shumica këto që KOK-u i ka siguruar nga sponsorët. Premitë do t'u ndahen dy kampioneve olimpikë, bashkë me trajnerin e tyre, Driton Kuka, si dhe nëntë sportistëve të tjerë që, pavarësisht se nuk ishin në podium, dhanë maksimumin e tyre. Me mbylljen e 'Tokio 2020' sot po e hapim rrugën drejt 'Paris 2024', ku do të nënshkruajmë bursa me 22 sportistë të përzgjedhur nga Komisioni i Sportistëve, listë kjo që mund të ndryshojë varësisht nga performanca e tyre, e cila do të monitorohet vazhdimisht nga ky komision", ka thënë presidenti Krasniqi, duke uruar që shumica e këtyre sportistëve të fitojnë normën olimpikë. 7 500 dollarë në muaj është shumica që ndan Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar për bursistët, ndërsa me vendim të Bordit Ekzekutiv, KOK-u ka shtuar edhe



1 550 euro në muaj, që në total për 2 vjet e gjysmë do të ndahen 46 500 euro, pa i llogaritur këtu përfitimet e tjera që do të kenë sportistët, me dërgimin në kampe jashtë vendit, në mënyrë që të jenë sa më të përgatitur për Lojërat e ardhshme Olimpikë. 22 sportistët do të mbështeten me shumica prej 250 dollarësh deri në 1 000 dollarë. Nga 1 000 dollarë u takojnë kampioneve olimpikë, Krasniqi e Gjakova. Në fjalën e tij, ministri Çeku foli për rëndësinë që kishte pranimi i KOK-ut dhe federatave sportive në arenën ndërkombëtare, derisa u ndal te suksesi në "Tokio 2020" dhe mbështetja e KOK-ut drejt "Paris

2024". "Është kënaqësi e madhe kur në listën e bursave shoh sportistë që ishin edhe në Tokio. Drejt Parisit ju pret një rrugë e gjatë përpara. Ju uroj suksese në procesin përgatitor jo vetëm juve, por të gjithë sportistët që kanë për qëllim ta përfaqësojnë Kosovën në arenën ndërkombëtare. Shpresoj shumë që në Paris të shkojmë me më shumë sportistë, më shumë norma olimpikë dhe të kthehemi me më shumë medalje", tha ministri Çeku. Mjeshtri ndërkombëtar Driton Kuka përgëzoi KOK-un për përkrahjen që po ua bënë sportistëve, me theks të veçantë

u ndal te 22 Bursat Olimpikë Paris 2024. "Është kënaqësi që KOK po i drejton 22 sportistë drejt Parisit. Tani nuk kanë arsye për ankese. Shpresoj që të paktën të kemi 10 të kualifikuar, kurse unë si trajner shpresoj të kthehem me medalje, sepse të kalohet Tokio 2020 është shumë e vështirë", ka deklaruar Kuka. KOK-u u falënderua edhe nga kampionia olimpikë Nora Gjakova dhe mundësi Egzon Shala, të cilët folën në emër të sportistëve, me besimin se drejt kryeqytetit të Francës do të udhëtojnë me më shumë norma olimpikë dhe të arrijnë sa më shumë suksese.

Kosova i luan dy ndeshje kontrolluese ndaj Kuvajtit



PRISHTINË, 9 DHJETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll i luan dy ndeshje miqësore me kombëtaren e Kuvajtit. Ndeshjet luhen më 17 dhe 19 dhjetor në Podgoricë. Grumbullimi i "dardanëve" bëhet më 15 dhjetor në Prishtinë, ndërsa udhëtimi është një ditë më vonë. Përzgjedhësi Bujar Qerimi pritet t'ua japë rastin lojtarëve që kanë

pasur më pak hapësirë në takimet e kaluara. Po ashtu, do të ftohen lojtarë që janë shquar në klubet e Superligës e që vlerësohen me potencial për vend në Përfaqësuesë. Ndeshjet me Kuvajtin vlerësohen me rëndësi për ta rritur konkurrencën në Përfaqësuesen e Kosovës dhe për ta zgjeruar bazën për selektimet e ardhshme. Kuvajti

është rival cilësor dhe në rritje të vazhdueshme. "Ndërkohë po vazhdojnë negociatat për të aranzhuar dy miqësore me Arabinë Saudite. Ato mund të luhen në javën e fundit të dhjetorit. Të kujtojmë që Përfaqësuesja e Kosovës grumbullohet më 25 dhjetor për ndeshjet kualifikuese të janarit", thuhet në njoftimin e Federatës së Hendbollit të Kosovës.

Ndeshja Llapi - Prishtina zhvillohet në Lipjan

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Komisioni i Garave ka vendosur që ndeshja e xhiros së 18 në BKT Superligën e Kosovës në futboll, në mes të Llapit dhe Prishtinës, të zhvillohet në stadiumin "Sami Kelmendi" në Lipjan. "Një gjë e tillë është vendosur

për shkak të terrenit jo të përshtatshëm për lojë në stadiumin e Merdarit, ku deri më tash i ka zhvilluar ndeshjet si vendase skuadra e Llapit. Dueli Llapi - Prishtina luhet të shtunën, me fillim nga ora 13:00", thuhet në njoftimin e FC

Prishtina. Sfidat është e një rëndësie të veçantë për të dyja ekipet, pasi si Prishtina ashtu edhe Llapi synon pjesën e epërme të tabelës. Prishtina pas këtij takimi ndodhet në pozitën e pestë me 24 pikë, kurse Llapi zë vendin e katërt me 26 sosh.



Nagelsmanni: Jemi në rrugën e duhur për ta fituar Ligën e Kampionëve

MUNCHEN, 9 DHJETOR - Bayern Muncheni fitoi me rezultat 3-0 ndaj Barcelonës në Ligën e Kampionëve, e mbylli fazën e grupeve me 18 pikë të plota dhe spostoi ekipin katalanas në Ligën e Evropës. "Bavarezët" triumfuan me të

njëtin rezultat si në "Camp Nou" dhe cilësohen si një nga ekipet favorite për fitoren e turneut më të rëndësishëm për klube. Trajneri i kampionëve të Gjermanisë, Julian Nagelsmann, nuk fshihet dhe

pranon se djemtë e tij do të luftojnë deri në fund për të sjellë kupën me veshë të mëdhenj në Munchen. "Ne e kemi detyrim të jemi favoritë, kemi një dëshirë të madhe për të fituar këtë kompeticion. Jemi në rrugën


e duhur, duhet të vazhdojmë kështu përpara. Ka rëndësi të madhe ta mbajmë të njëtin nivel dhe ritëm, unë kam shumë besim se mund t'ia dalim ta fitojmë Ligën e Kampionëve", ka deklaruar Nagelsmanni.



Ibra: Nuk e di pse nuk e fitova kurrë 'Topin e Artë'

MILANO, 9 DHJETOR - "Jemi të zhgënjyer dhe na vjen shumë keq, por do të luftojmë për ta fituar titullin e Serisë A. Ne nuk dorëzohemi. Do të bëjmë gjithçka për të pasur sukses". Kështu e nis intervistën e gjatë Zlatan Ibrahimoviçi për "Radio DeeJay". Aty shfrytëzoi rastin ta nënvizonte edhe marrëdhënien e tij të madhe me Italinë: "Është vendi që më bëri ky që jam sot. Gjithçka filloi në Itali. Holanda ka një shkollë të madhe talentesh, por unë kam kaluar shumë vite këtu dhe kjo është shtëpia ime e dytë. Ndiej shumë mirënjohje për Italinë".

Me karakterin që ka, e pranon hapur rolin e liderit të Milanit brenda dhe jashtë fushës: "Jam shumë i përqendruar dhe e di se çfarë duhet të bëj. Kam përgjegjësi ndaj shokëve të mi, ata më shikojnë, sepse flas në fushë dhe në dhomat e zhveshjes. Ata ndihen të mbrojtur, por duhet të marrin edhe përgjegjësi të tyre". Gjiganti suedez i rikthehet sërish asaj që ka zbuluar në librin e tij të fundit "Adrenalina", se ishte fare pranë kalimit të Napoli. "Isha në Amerikë, por Raiola më thoshte të kthehesha për të luajtur në Evropë. Mbj mend që pashë një dokumentar për Maradonën dhe tifozët e Napolit ishin të pabesueshëm. Unë fola me De Laurentiis dhe ditën kur duhej të



nënshkruaja, ai largoi Ancelottin. Gjithçka u krye, Ancelotti më bindi, fola shumë me të, por kur ai u largua u ndjeva më pak i sigurt. Në atë moment mbërriti Milani dhe gjërat shkuan mirë", ka shtuar sulmuesi suedez. Një moment dramatik për të ishte dëmtimi i rëndë që pësoi te Manchester Unitedi: "E theva gjurin tim në moshën 35-vjeçare, të gjithë menduan se kisha mbaruar. Gjithçka është çështje mentaliteti, kur më thonë gjëra të caktuara është sikur i hedhin benzinë zjarrit. I vendosa vetes synime pa e ditur se si do të shkonte". Ai sakrifikon duke luajtur në Itali, sepse e ka larg familjen: "Është e vështirë, shumë e vështirë. Plani

ishte të shkoja te Napoli për katër muaj, të fitoja titullin dhe më pas të kthehesha në Suedi. Pastaj erdhi Milani, gjërat shkuan mirë dhe vendosa të rinovoj, pa i thënë asgjë gruas sime. Ndoqa pasionin. Sa herë që afrohet tërheqja, unë e zgjas karrierën".

Ibra është një nga lojtarët më të fortë të gjeneratës së tij, por nuk e ka fituar kurrë "Topin e Artë": "Nuk e di pse nuk e fitova, nuk fitova as Ligën e Kampionëve dhe thonë se nuk do ta fitoj kurrë. Kjo nuk e ndryshon aspak karrierën time, aq cilësitë që kam si futbollist. Kam luajtur në ekipe të mëdha, me lojtarë të mëdhenj, kam mësuar disa gjuhë dhe kam fituar diçka...".

Golden State kryeson renditjen, humbasin Milwaukee dhe Brooklynin

HOUSTON, 9 DHJETOR - Skuadra e Golden States korri fitoren e 22-të sezonale në NBA pas fitores 104-94 ndaj Portlandit, duke kryesuar renditjen në Konferencën e Perëndimit. Curry me 22 pikë e Poole me 20 ishin më të mirët në parket, duke i bërë të pavlefshme 26 pikët e Powellit për miqtë. Fiton edhe



Utah Jazzi, që mundi 136-104 Minnesotan jashtë fushës, ndeshje ku u dallua Mitchell me 36 pikë. Surprizë humbja e kampionit Milwaukee, që u mundi 113-104 nga Miami. 40 pikë erdhën nga lojtarët e stolit, ndërkohë që u dallua Martini me 28 pikë. Humbet edhe ekipi i

Brooklynit, që u mundi 114-104 ndaj Houstonit, ndeshje ku gjashtë lojtarë të Rocketsit realizuan mbi 10 pikë. Mungesa e Durantit u ndje te Netsi, që ndau kreun e renditjes me Chicago. Edhe Bullsi u mundi 115-92 nga Clevelandi, sfidë ku për vendasit u dallua Garlandi me 24 pikë.

SHKURT

Todesco emërohet trajner i RB Leipzigut

Domenico Todesco është emëruar trajner i RB Leipzigut. Pas shkarkimit të Jesse Marsch për rezultate të dobëta, klubi gjerman e ka zëvendësuar me Todescon. 36-vjeçari ka nënshkruar kontratë deri në qershorin e vitit 2023 dhe këtë e konfirmoi klubi përmes një komunikate në "Twitter". "Mirë se vjen te RB Leipzig, Domenico Todesco! 36-vjeçari do të vazhdojë në krye deri në qershorin e vitit 2023", thuhet në njoftimin e klubit gjerman.

Xavi: E kemi prekur fundin, tash nis një epokë e re

Pas shumë vjetësh, Barcelona do të rikthehet të luajë në Ligën e Evropës. Të besuarit e Xavi Hernandezit u mundën 3-0 nga Bayern Munichu në sfidën e fundit, në anën tjetër rivalja për vendin e dytë, Benfica, fitoi finalen e saj. Xavi është shprehur tejet i mërziut pas këtij eliminimi. "Nuk e meritojmë të jemi në Ligën e Evropës. Mendova se mund të konkurronim më mirë, por realiteti është se nuk mundëm. Më dhemb shumë, nuk mund të përballojmë të jemi në këtë situatë, e kemi prekur fundin. Është koha të nisim gjithçka nga e para", ka thënë Xavi.

Arsenali synon transferimin e Richarlisonin

Skuadra e Arsenalit është duke planifikuar transferimin e Richarlison, raporton "Fichajes". Ylli brazilian e ka shënuar golin e barazimit në përballje në mes të Evertonit dhe Arsenalit (2-1), derisa VAR-i ia ka anuluar edhe dy gola të tjerë. 24-vjeçari është pjesë e Evertonit nga viti 2018 ku ka regjistruar 115 paraqitje dhe ka shënuar 36 gola.

Vajza e Peles: Kjo është vizita e fundit e vitit në spital

"Për dy ose tri ditë ai vjen në shtëpi për t'i shijuar Krishtlindjet. Kjo nuk ishte një surprizë". Vajzat e Peles donin t'i qetësonin fansat përmes rrjeteve sociale për kushtet shëndetësore të kampionit brazilian, i shtruar në spitalin "Albert Einstein" në Sao Paulo. "Shtrimi në spital tashmë ishte planifikuar dhe është pjesë e trajtimit", ka shkruar Kely Nascimento në "Instagram", duke postuar një foto në të cilën motra e saj, Flavia Kurtz, përqafohet babanë e saj të buzëqeshur në një shtrat spitalor. Duke publikuar të njëjtin imazh, Flavia Kurtz i ftoi të gjithë të jenë "të qetë", duke shpjeguar se "kjo është vizita e fundit e vitit në spital" për ta vazhduar "trajtimin, me teste kontrolli dhe kimioterapi, babai im është fantastik!". Pele, 81-vjeçar, u shtrua në spital për t'iu nënshtruar një cikli të ri trajtimit, pasi ishte operuar në të njëjtin spital për kancerin e zorrës së trashë, ta zbuluar shtatorin e kaluar, sipas një shënimi nga spitali "Albert Ajnshtajni": "Pacienti është në gjendje stabile dhe parashikohet që pas disa ditësh të dalë nga spitali".

Skuadra e Evertonit është shumë afër nënshkrimit me mesfushorin e Juventusit, Aaron Ramsey. Siç raporton "CalcioMercato", Ramsey është shumë afër rikthimit në Premierë Ligë, por jo tek Arsenalin, por tek Evertonin. Juventusit është gatë për ta lënë të lirë futbollistin në fjalë, pasi që ish-mesfushori i Arsenalit nuk është në planet e gjigantit italian. Ramsey është paraqitur vetëm pesë herë në të gjitha garat për Juven këtë sezon.

REZULTATET

Charlotte - Philadelphia	106-110
Cleveland - Chicago	115-92
Detroit - Washington	116-119
Indiana - New York	122-102
Miami - Milwaukee	113-104
Toronto - Oklahoma	109-110
Houston - Brooklyn	114-104
Memphis - Dallas	96-104
Minnesota - Utah Jazz	104-136
New Orleans - Denver	114-120
Golden State - Portland	104-94
Sacramento - Orlando	142-130
Clippers - Boston	114-111

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Trofta e Kabashit" Sh.p.k. Kabash, Prizren, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Akuakultur-Kultivimin e peshkut në Z.K.Korishë, Komuna e Prizrenit. Njoftohet publiku i interesuar se më datën 30.12.2021 në ora 10:00 do të organizohet Debatu Publik në Restorant „PIKNIK” i cili gjindet në rrugën Ukë Bytyqi magjistranja Prizren - Suharekë komuna e Prizrenit. Debatu publik organizohet nga Kompania "Trofta e Kabashit" Sh.p.k. Kabash, Prizren., në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debatu publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Akuakultur-Kultivimin e peshkut në Z.K.Korishë, Komuna e Prizrenit.

Debatu Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmpha1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Trofta e Kabashit" Sh.p.k. Kabash, Prizren për Akuakultur-Kultivimin e peshkut në Z.K.Korishë, Komuna e Prizrenit.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Aferdita Mulaj shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Shote Galica".
- ▶ Emrush Brahaj shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810570087.
- ▶ Shemsedin Xhema shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës "Musa Hoti".
- ▶ Valdete Kajtazi shpalle te pavlefshme dëftesat e SHMLM "Dr Xheladin Deda".
- ▶ Tafil Azemi shpalle te pavlefshme certifikatën e statusit martesor.
- ▶ Sali Bajrami shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT "Anton Çeta".
- ▶ EDG O.P me numër te regjistrimit te biznesit: 70557819 me adrese Prishtinë, Holger Pedersen Nr.11 shpalli te pavlefshme certifikatën e regjistrimit e leshura nga ARBK.
- ▶ Blerim Nue Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. IV të SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- ▶ Mirlind Rama shpall të pavlefshme diplomën e Gjinnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

